



REPUBLICA E KOSOVES
KOMUNA E VUSHTRISË
01 Nr. / Br 275 / 15
Nr. i fq. / Br. si - 1 -
Data / Datum 30.12.2015
VUSHTRRI - VUCITRI



## Republika e Kosovës

## Kuvendi i Komunës-Vushtrri


Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **30 dhjetor 2015**, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione për Ndihmë Momentale Personave Juridik (OJQ) dhe personave fizik duke u bazuar në nenin 12.1 pika "c" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2013 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

### V E N D I M

#### Për dhënien në diskutim Publik

- 1.Jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione për Ndihmë Momentale Personave Juridik (OJQ) dhe personave Fizik.
- 2.Diskutimi publik fillon nga data 08 janar 2016 dhe zgjatë deri më 21 janar 2016.
- 3.Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.
- 4.Obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale që si hartues dhe propozues i Draft-Rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.  
Gjithashtu DSHPS-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin janar 2016.
5. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova

  
Kryesues i Kuvendit



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E VUSHTRISË - OPSTINA VUSHTRIS  
01 Nr / Br 276 / 15  
Nr. I fq. / Br. sht. - 1 -  
Data / Datum 30-12-2015  
VENDIM - VEŠTITJE



Republika e Kosovës


Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Bazuar në nenin 10.2 ,nenin 13 pika "a", nenit 14 paragrafi 1 dhe 2, nenit 44.1 të Ligjit për Tokën Bujqësore Nr.02/L-26, nenit 6.2 të Udhëzimit Administrativ për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore Nr.41/2006, dhe nenin 12.2 pika "d "të Ligjit 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe nenin 41.2 pika (ç) të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **30 dhjetor 2015**, mori këtë:

### VENDIM

#### Mbi lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore

- 1.Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në parcelës kadastrale P-70202003-00014-0 me kulturë e klasës së katër (4), vendi i quajtur "Kodra Vorshi /Te Kershi" me sipërfaqe prej 1200m<sup>2</sup> e evidentuar në certifikatën mbi të drejtën e pronës së paluajtshme me nr.protokollit.18/644 të datës 11.11.2015, Zona Kadastrale Bajskë me pronar Kadri Hasani.
- 2.Në parcelën kadastrale të cekur në pikën 1 të këtij vendimi lejohet ndërtimi i objektit ekonomik (Fermë e Pulave).
- 3.Lejen ndërtimore dhe kushtet për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit nga pika 2 e këtij vendimi do ta lëshoj dhe përcaktoj konform dispozitave ligjore Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pas pagesës së tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore.
- 4.Obligohet pronari i parcelës nga pika 1 e këtij vendimi që të bëjë pagesën e tarifës për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore sipas nenit 14.2 pika "a" të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore Nr.41/2006, ku parashihet 1.00€/m<sup>2</sup> për mesë organit për bujqësi të KK-së Vushtrri.
- 5.Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Sektori i Bujqësisë në Drejtorinë e Ekonomisë.
6. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Shpëtim Zhegrova

Kryesues i Kuvendit



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRISË - OPSTINA VUSHTRN

01 Nr./Br 277/15

Nr. l fq./ Br. st - 1 -

Data: / Datum 30.12.2015

VUSHTRN - VUSHTRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në mbështetje të nenit 12.2 “d” të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 9 paragrafi 4 të Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së paluajtshme të Komunës nenit 3 të Rregullores QRK Nr.23/2013 për Caktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës se Paluajtshme të Komunës si dhe 41.2 pika “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrisë në mbledhjen e mbajtur më **30 dhjetor 2015** mori këtë:

### VENDIM

#### Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr.46/14 të datës 27.02.2014

- 1.Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet Vendimi Nr.46/14 të datës 27.02.2014 i Kuvendit të Komunës së Vushtrisë lidhur me ankesat e palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme komunale, ku në vend të Enver Morines zgjidhet **Albanez Tahiraj**, nga Zyra Ligjore.
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: kryetari i komunës dhe anëtari i komisionit.
5. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**  
  
**Shpëtim Zhegrova**

